



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 13/2009

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, në panelin e përbërë nga Osman Tmava, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Muharrem Shala, anëtarë, përkitazi me Ankesën e degës së LDK-së në Viti, në seancën e mbajtur më datë 20.10.2009, mori

VENDIM

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

ARSYETIMI

Komisioni për Ankesa dhe Parashtrësia i Degës së LDK-së në Viti, ka parashtruar ankesë me të cilën pretendon se përfaqësuesit e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), kanë bërë shkelje ligjore .

FAKTET

Më 13 Tetor 2009, Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP) ka pranuar një ankesë që i ishte dorëzuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) më 13 Tetor 2009, nga Komisioni për Ankesa dhe Parashtrësia i Degës së LDK-së në Viti, duke pretenduar se përfaqësuesit e subjektit politik të AAK-së, kanë bërë shkelje ligjore, *për Fushatën e Zgjedhjeve të Subjekteve Politike*, ashtu që në qytetin e Vitisë kanë vendosur billbordet e kandidatit për kryetar të komunës së Vitisë, Z. Enver Rrustemi, para fillimit të periudhës së fushatës zgjedhore, të datës 15 Tetor 2009. Ankuesi ka bashkangjitur fotografimin që duken të jenë billbordet e fushatës së AAK-së.

ANALIZË

Jurisdiksioni i KZAP'it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

Parashtruesi i ankesës pretendon se përfaqësuesit e AAK-së, kanë shkelur Rregullën e zgjedhjeve për *Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike* sepse kanë vendosur billbordet në qytetin e Vitisë para fillimit të fushatës së zgjedhjeve, datë 15 Tetor 2009.

LZP me dispozitën e nenit 44, përcaktohen aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore në mënyrat e specifikuar me atë dispozitë ligjore.

LZP me dispozitën e nenit 33 dhe Rregullorja e Zgjedhjeve Nr 11/2009, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, me dispozitën e nenit 4, u ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësve të tyre ose kandidatëve të tyre, të caktuara me këto dispozita ligjore gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Meqenëse veprimet e pretenduara nuk janë bërë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, vlerësohet në pajtim me dispozitat e cituara ligjore se nuk kemi të bëjmë me veprime të ndaluara, për çka edhe vlerësohet se ankesa është e pabazuar.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

A nr. 13/2009 më datën 20.10.2009.

Kryesuesi i Panelit

~~Osman Tmava~~
